

VENDIM
Nr.362, datë 1.4.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE TË
DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË
HUAJVE NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË**

(Ndryshuar me VKM nr. 431, datë 27.4.2009)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, pikat 1 e 2, 14, pika 5, 15, pikat 1 e 3, 16, pika 4, 19, pika 6, 24, pikat 1 e 4, 30, pika 3, 32, pika 1, shkronja “dh”, 36, pika 3, 37, pika 4, 67, pika 1, 93, pika 2, 94, pika 5, 104, pika 2, e 108, të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Të huajt, që hyjnë, tranzitojnë, qëndrojnë dhe dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë janë të detyruar ta kalojnë kufirin shtetëror vetëm nëpërmjet pikave të kalimit kufitar (PKK). Kalimi i kufirit shtetëror jashtë PKK-ve vlerësohet i paligjshëm, me përjashtim të rasteve të parashikuara me marrëveshje dy apo shumëpalëshe, si dhe rasteve kur shtetas të huaj paraqiten në kufirin shtetëror për të kërkuar azil apo mbrojtje në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me konventat ndërkombëtare, të njohura nga Republika e Shqipërisë.

2. Në PKK-të dhe jashtë tyre, pas kontrollit të dokumenteve në hyrje dhe dalje, bëhet evidentimi i të huajve, që nënkupton:

a) regjistrimin e të gjithë të huajve që hyjnë dhe dalin në mënyrë të ligjshme nga Republika e Shqipërisë;

b) regjistrimin e të huajve, të cilëve, për arsye të parashikuara në ligj ose në akte nënligjore, u refuzohet hyrja në territor;

c) regjistrimin e të huajve, të cilët hyjnë ose kanë hyrë në territor në mënyrë të paligjshme;

ç) regjistrimin në dalje të shtetasve të huaj që kanë qëndruar në territor në mënyrë të parregullt ose në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt".

3. I huaji, i cili sipas parashikimeve të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt", paraqitet, brenda 30 ditëve qëndrimi pa ndërprerje, pranë Drejtorisë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin ose në zyrat e migracionit, në komisariatet e Policisë Kufitare dhe Migracionit në territorin ku do të qëndrojë dhe plotëson formularin tip nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Të huajve, që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë me vizë, mund t'u kërkohej nga autoritetet e kontrollit kufitar në PKK një ose disa nga dokumentet mbështetëse të mëposhtme:

a) Ftesa e pritësit në Shqipëri;

b) Bileta e kthimit;

c) Konfirmimi për akomodimin;

ç) Leja e punës;

d) Mjetet financiare, sipas parashikimit të nenit 10 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt";

dh) Kartela origjinale e vaksinimit ndërkombëtar, kur personi vjen nga vende të prekura

nga epidemi ose sëmundje, për të cilat legjislacioni shqiptar e kërkon. Kur personi nuk e ka këtë kartelë, njoftohen strukturat e specializuara të Ministrisë së Shëndetësisë, për të marrë së bashku masat e duhura, sipas legjislacionit në fuqi.

II. KRITERET, PROCEDURAT DHE DOKUMENTACIONI PËR PAJISJEN ME VIZË

Pranë zyrave konsullore, në përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit, aplikuesi për vizë, i cili udhëton me pasaportë të thjeshtë, paraqet këto dokumente për:

A) Vizë të tipit A

a) Pasaportën, e cila duhet të skadojë të paktën 3 muaj pas mbarimit të afatit të vizës së kërkuar.

b) Fotokopjen e fletës me gjeneralitete të pasaportës.

c) Fotokopjen e fletëve të tjera të pasaportës, që japin informacione të rëndësishme për udhëtimin.

ç) Formularin tip nr. 2 të plotësuar dhe dy fotografi të kohëve të fundit format dokumenti.

d) Fotokopje të vizës së vendit tek i cili do të mbërrijë, nëse është e nevojshme pajisja me vizë për hyrjen në atë vend.

dh) Policën e sigurimit shëndetësor për ditët e kërkuara për kalim tranzit.

e) Kartelën e vaksinimit, kur i huaji vjen nga vende të prekura nga epidemi.

Rastet e aplikimit të kësaj vize dhe lista e shteteve që i nënshtrohen, do të pasqyrohen, sipas nevojave si anekse të këtij vendimi. Kjo listë do të përditësohet në vazhdimësi, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme.

B) Vizë të tipit B:

a) Pasaportën, e cila duhet të skadojë të paktën 3 muaj pas mbarimit të afatit të vizës së kërkuar.

b) Fotokopjen e fletës me gjeneralitetet e pasaportës, si dhe të fletëve të tjera, me informacione të rëndësishme për udhëtimin.

c) Fotokopje të vizës së vendit tek i cili do të mbërrijë, nëse është e nevojshme pajisja me vizë për hyrjen në atë vend.

ç) Formularin tip nr. 2, të plotësuar, dhe dy fotografi të kohëve të fundit, format dokumenti.

d) Policën e sigurimit shëndetësor për ditët e kërkuara për kalim tranzit.

dh) Mjetet financiare, sipas parashikimit të nenit 10 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt", të mjaftueshme për ditët e kalimit tranzit, sipas parashikimeve në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Punëve të Jashtme.

e) Kartelën e vaksinimit, kur i huaji vjen nga vende të prekura nga epidemi.

C) Vizë të tipit C:

C.1. Dokumentet bazë:

a) Pasaportën, e cila duhet të skadojë të paktën 3 muaj pas mbarimit të afatit të vizës së kërkuar.

b) Fotokopjen e fletës me gjeneralitetet e pasaportës, si dhe të fletëve të tjera me informacione të rëndësishme për udhëtimin.

c) Formularin tip nr. 2, të plotësuar, dhe dy fotografi të kohëve të fundit format dokumenti.

ç) Fotokopjen e dokumentit të sigurimit shëndetësor.

d) Dokumentin e pronotimit vajtje-ardhjeje, biletën ose të vërtetojë mundësinë e transportit personal.

dh) Një deklaratë të rregullt sipas legjislacionit të vendit përkatës, të lëshuar nga

prindi/ërit (kujdestari), që lejon/lejojnë udhëtimin, në rastet e të miturve.

C.2. Dokumente të veçanta shtesë, sipas motivit:

C.2.1. Për turizëm:

a) Garancinë financiare, të provuar nëpërmjet dokumenteve, të përcaktuara në nenin 10 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt", në shumën parashikuar në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Punëve të Jashtme.

b) Dokumentin, që vërteton ekzistencën e një marrëdhënieje punësimi të qëndrueshme në vendin e origjinës. Në mungesë të kësaj marrëdhënieje punësimi, i huaji duhet të vërtetojë se ka interesa për t'u kthyer në vendin e origjinës, me paraqitjen e një vërtetimi pensioni ose të ardhura të ndryshme.

Dëshmitë e punës duhet të plotësohen dhe nënshkruhen nga punëdhënësi, në një letër format, ku në krye të jetë logoja e stema e shoqërisë, institucionit apo subjektit tjetër, dhe të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:

- Gjeneralitetet e kërkuesit të vizës dhe numrin e pasaportës;
- Detyrat që ka kryer punonjësi;
- Datën e punësimit;
- Periudhën e pushimeve;
- Rrogën mujore;
- Adresën e saktë dhe të plotë të shoqërisë, institucionit apo subjektit tjetër.

c) Dokumentet, që vërtetojnë qëndrimin.

- Në rast se do të qëndrohet pranë një strukture hotelerie shqiptare, duhet të paraqitet një rezervim hoteli për periudhën e kërkuar të qëndrimit.

- Në rast se zotëron një deklaratë mikpritjeje nga një shtetas shqiptar apo i huaj, banues i rregullt në Republikën e Shqipërisë, deklarata duhet të plotësohet sipas formularit nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, duke treguar me saktësi periudhën e qëndrimit, mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit për të gjithë periudhën, deklaratën e marrjes përsipër të përgjegjësisë ligjore nga personi, që bën garancinë, nëse i ftuari shkel ligjin "Për të huajt", të shoqëruar me dokumentin e identifikimit ose pasaportën, nëse është shtetas shqiptar, apo kopjen e lejes së qëndrimit, të vlefshme, nëse është shtetas i huaj.

C.2.2. Për turizëm, të organizuar në grupe turistike, të ftuara nga një shoqëri turistike shqiptare

- Fotokopjen e fletës së pasaportës që tregon hyrjen dhe qëndrimin e ligjshëm të shtetasit të huaj në vendin ku ndodhet në çastin e aplikimit për vizë.

- Dokumentacionin, që provon qëndrimin të të huajt për qëllime turistike në vendin, ku do të bëhet aplikimi për vizë.

- Fotokopjen e noterizuar të licencës së shoqërisë turistike shqiptare, e cila fton grupin turistik të huaj për turizëm.

- Deklaratën e garancisë për grupin turistik.

C.2.3. Për motive kulturore dhe sportive

a) Ftesën nga subjekti kulturor, sportiv, vendas, për pjesëmarrjen e të huajt në veprimtarinë për të cilin kërkohet lëshimi i vizës përkatëse.

b) Rezervimin e hotelit apo deklaratën e mikpritjes.

c) Garancinë financiare, të provuar nëpërmjet dokumenteve, të përcaktuar në nenin 10 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt", për ditët e qëndrimit, e cila përllogaritet në bazë të shumave, të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë.

ç) Dokumentin që vërteton ekzistencën e një marrëdhënieje kulturore ose sportive të qëndrueshme në vendin e origjinës, të kërkuesit të vizës, të përkthyer dhe të vërtetuar nga autoritetet përkatëse vendase.

C.2.4. Për motive zyrtare

- a) Ftesën nga institucioni pritës.
- b) Notën verbale nga institucioni, ku i huaji është i punësuar.

C.2.5. Për motive mjekësore

- a) Ftesën nga institucioni pritës.
- b) Epikrizën, origjinali apo fotokopje, kryesisht për diagnozës, të lëshuar nga mjeku vendas e të përkthyer dhe të vërtetuar nga autoriteti përkatës vendas.
- c) Deklaratën e institucionit spitalor, publik apo privat, të licencuar, ku të përcaktohen: lloji i trajtimit mjekësor, data e fillimit dhe, përafërsisht, kohëzgjatja e trajtimit mjekësor, kostoja e përafërt e trajtimit, si dhe subjekti, që do t'i mbulojë këto kosto.
- ç) Dokumentet që dëshmojnë ekzistencën e burimeve, të nevojshme e të mjaftueshme, për të mbuluar pjesën e shpenzimeve shëndetësore, si dhe ato të qëndrimit jashtë strukturës shëndetësore, apo të kthimit në atdhe të personit, që kurohet, dhe të shoqëruesit të tij, sipas nenit 10 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt".
- d) Sigurimin shëndetësor të shoqëruesit/ve të të sëmurit, për të përballuar shpenzimet e nevojshme në rast shtrimi të menjëhershëm, për qëndrimin e tij në Shqipëri, si dhe shpenzimet e kthimit në atdhe.

C.2.6. Për motive pune (profesionale, tregtare)

- a) Ftesën nga subjekti pritës.
- b) Dokumentin, që provon veprimtarinë profesionale, tregtare në vendin përkatës, me të cilin lidhen motivet e vizitës.
- c) Në rastin e subjektit tregtar, dokumentet që provojnë statusin juridik të subjektit.
- ç) Kopje të dokumentit më të fundit zyrtar, të lëshuar nga organet përkatëse vendase, që vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore, të vërtetuara me origjinalin, sipas parashikimit të legjislacionit të vendit përkatës.

Për shoferët do të kërkojnë edhe:

- i) licenca e transportit ndërkombëtar të mjetit (kamionit);
- ii) leja e qarkullimit ndërkombëtar;
- iii) patenta ndërkombëtare.

D. Vizë të tipit D

D.1. Dokumentet bazë:

- a) Pasaportën, e cila duhet të skadojë të paktën 3 muaj pas mbarimit të afatit të vizës së kërkuar.
- b) Fotokopjen e fletës me gjeneralitetet e pasaportës, si dhe të fletëve të tjera, me të dhëna të rëndësishme për udhëtimin.
- c) Dy fotografi të kohëve të fundit, format dokumenti.
- ç) Formularin e tipit nr. 2, të plotësuar.
- d) Dokumentin e sigurimit shëndetësor.
- dh) Deklaratën e rregullt, sipas legjislacionit të vendit përkatës, të lëshuar nga prindi/ërit (kujdestari), që lejon/jnë udhëtimin e të miturit.
- e) Dëshmi penaliteti, të lëshuar jo më vonë se një muaj para aplikimit.

D.2.1. Dokumente të veçanta shtesë për vizat D/AE/AP/AT/APU

- a) Ftesën nga subjekti pritës.
- b) Dokumentin, që provon veprimtarinë profesionale, tregtare në vendin e aplikuesit, me të cilët lidhen motivet e kërkesës së vizës.
- c) Në rastin e subjektit tregtar, dokumentet që provojnë statusin juridik të subjektit.
- ç) Kopje të dokumentit më të fundit zyrtar, të lëshuar nga organet përkatëse vendase, që vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore, të vërtetuara

me origjinalin sipas parashikimit të legjislacionit të vendit përkatës.

d) Kontratë pune me pritësin në Shqipëri.

dh) Lejen e punës, të lëshuar nga autoriteti përkatës shqiptar.

e) Dokumentin, që provon regjistrimin e të huajit, që kërkon vizë, në institucionet përgjegjëse të punësimit në vendin e vet, të njohura sipas marrëveshjeve për punësim.

D.2.2. Dokumentet e veçanta shtesë për vizat D/ST

a) Dokumentin, që vërteton pranimin në një institucion arsimor shqiptar.

b) Garancinë pasurore, që vërteton mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe të shkollimit.

c) Dokumentin e sigurimit shëndetësor, që përkon me kohëzgjatjen e qëndrimit në territor.

ç) Deklaratën e të huajit rreth mundësisë së strehimit në Republikën e Shqipërisë.

d) Dokumentin, që provon njohjen e gjuhës, me të cilën kërkuesi i vizës do të kryejë studimet. Prova e njohjes së gjuhës mund të bëhet edhe me intervistë nga personeli i përfaqësisë.

D.2.3. Dokumentet e veçanta shtesë për vizat D/BF

a) Fotokopjen e lejes së qëndrimit në Shqipëri të të huajit, i cili kërkon bashkimin familjar, të noterizuar dhe legalizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë.

b) Certifikatë lindjeje personale, me fotografi, të të huajit, që aplikon për bashkim familjar.

c) Certifikatën e lëshuar, jo më shumë se një muaj para aplikimit për vizë, nga autoritetet përkatëse në vendin e origjinës, e cila vërteton lidhjen e personit, që kërkon bashkim familjar në Shqipëri.

ç) Dokumente të tjera shtesë (fotografi, filmime etj.), që provojnë lidhjen e qëndrueshme me personin, që kërkon bashkim familjar.

d) Dokumente, që vërtetojnë se pritësi ka një banesë të përshtatshme në Shqipëri (kontratë qiraje apo dokument që tregon se ka në pronësi një banesë).

dh) Dokumentin që vërteton se i huaji pritës është i punësuar apo i vetëpunësuar dhe ka sasi të mjaftueshme të ardhurash për të siguruar jetën e personit/ave që do të vijin në Republikën e Shqipërisë.

D.2.4. Dokumentet specifike shtesë për vizat D/AF

a) Certifikatë lindjeje personale, me fotografi, e të huajit, që aplikon për bashkim familjar.

b) Certifikatë lindjeje origjinale e shtetasit shqiptar, me të cilin i huaji kërkon të bëjë bashkim familjar, e legalizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë.

c) Certifikatën, e lëshuar nga autoritetet përkatëse në vendin e origjinës, e cila vërteton lidhjen me personin, me të cilin kërkon bashkim familjar në Shqipëri.

ç) Dokumente të tjera shtesë (fotografi, filmime etj.), që provojnë lidhjen e qëndrueshme me personin, me të cilin kërkon bashkim familjar.

D.2.5. Dokumentet specifike shtesë për vizat D/VHF

a) Certifikatë lindjeje personale, me fotografi, e të huajit, që aplikon për vizë.

b) Fotokopje të licencës së ushtrimit të veprimtarive humanitare.

c) Deklaratë nga subjekti i njohur nga shteti shqiptar, për motivin e ardhjes.

D.2.6. Dokumentet specifike shtesë për vizat D/DS

a) Notë verbale nga institucioni, ku është punësuar i huaji, që aplikon për vizë.

b) Ftesë nga institucioni pritës, kur është e nevojshme.

D.2.7. Dokumentet specifike shtesë për vizat D/QT

a) Certifikatë lindjeje personale, me fotografi, dhe familjare e të huajit, që aplikon për vizë.

b) Dokumente, që provojnë qëllimet e tjera, për të cilat kërkohet viza.

D.2.8. Dokumentet specifike shtesë për vizat D/PS

a) Ftesën nga subjekti pritës.

b) Kontratë pune me pritësin në Shqipëri.

c) Leje pune, e lëshuar nga autoriteti përkatës shqiptar.

ç) Dokumentin, i cili provon regjistrimin e të huajit, që kërkon vizë në institucionet përgjegjëse të punësimit në vendin e vet, të njohura sipas marrëveshjeve për punësim sezonal.

D.2.9. Dokumentet specifike shtesë për vizat D/H

a) Certifikatë lindjeje personale, me fotografi, dhe familjare, të të huajit që aplikon për vizë.

b) Dokumente, që provojnë qëllimet e tjera për të cilat kërkohet viza.

2. Viza afatgjatë e tipit "D", e dhënë me afat qëndrimi 180 ditë, për një afat shfrytëzimi një vit, përdoret nga i huaji duke respektuar kriterin 90 ditë për 180 ditë, me përjashtim të rasteve të parashikuara për vizat D/PS, në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt".

3. Përjashtohen nga detyrimi për t'u paraqitur personalisht në përfaqësitë shqiptare, për të cilat gjykohet rast pas rastit:

a) Të huajt e pajisur me pasaportë diplomatike.

b) Raste humanitare.

c) Personalitetet e larta shtetërore dhe delegacionet, që i shoqërojnë në vizitat për qëllime zyrtare.

ç) Të huajt, e organizuar në grupe turistike, të ftuar nga një shoqëri turistike shqiptare, të cilët aplikojnë në njërin nga përfaqësitë tona konsullore, në vendet fqinjë ose në vende të tjera, të ndryshme nga ato të origjinës.

4. Aplikimi për vizë nga të huajt, në vendet e të cilëve apo dhe në vendet fqinjë me ta nuk ka përfaqësi diplomatike shqiptare, bëhet me kërkesë në përfaqësinë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në njërin nga vendet e përcaktuara në listën nr. 4 që i bashkëlidhet këtij vendimi. Aplikimi për vizë jashtë vendeve të përcaktuara në këto lista bëhet vetëm me miratim të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Autoriteti dhe procedurat e miratimit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Punëve të Jashtme.

5. Për të miturit, që, për arsye të ndryshme, nuk janë pajisur me pasaportë vetjake, viza shënohet në vizën e prindit ose të kujdestarit ligjor, në pasaportën e të cilit janë të regjistruar të miturit, sipas renditjes së regjistrimit të tyre në pasaportë, tek opsioni në pullën vizë "shënime", me inicialet X1, X2, X3 etj.

6. Aplikimi për vizë, nga të huajt e organizuar në grupe turistike, të ftuar nga një shoqëri turistike shqiptare, kur bëhet në një nga përfaqësitë tona konsullore në vendet fqinjë ose në vendet e tjera të ndryshme nga ato të origjinës, mund të bëhet dhe nga përfaqësuesi i shoqërisë turistike. Procedura e lëshimit apo refuzimit të vizës në këtë rast zgjat jo më shumë se 24 orë.

Procedura miratohet me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Ministrit të Brendshëm.

7. Të gjitha dokumentet, që duhet të paraqiten për marrjen e vizës, sipas përcaktimeve të këtij vendimi duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të vërtetuara nga autoritetet përgjegjëse.

8. Procedura për lëshimin e vizës në kufi, për rastet e parashikuara në ligjin nr.9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt", përcaktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Punëve të Jashtme.

9. Vendet, shtetasit e të cilëve hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë, me pasaportë të thjeshtë ose kartë identiteti, janë pasqyruar në lidhjen nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

10. Vendet, shtetasit e të cilëve hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë, me pasaportë diplomatike ose shërbimi janë të pasqyruara në lidhjen nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

11. Vendet, shtetasit e të cilëve hyjnë në Republikën e Shqipërisë me vizë, dhe çmimet përkatëse të vizave, janë pasqyruar në lidhjen nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Vendet, shtetasit e të cilëve të organizuar në grupe turistike, aplikojnë për vizë turistike, të ftuar nga një shoqëri turistike shqiptare, në njërin nga përfaqësitë tona konsullore në vendet fqinje ose vendet e tjera të ndryshme nga ato të origjinës, si dhe çmimet përkatëse të vizave, janë pasqyruar në lidhjen nr. 7/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Përfundimi nga taksa e vizës mund të bëhet për arsye të justifikuar shtetërore, me kërkesë të autoritetit të institucionit shtetëror dhe miratimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, si dhe të ambasadorëve të Republikës së Shqipërisë, në përfaqësitë diplomatike jashtë shtetit.

12. Në rastet e anulimit, bërjes së pavlefshme apo refuzimit të vizës, sipas shkronjave “b” e “ç” të nenit 19 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt", kur i huaji ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Punëve të Jashtme është përgjegjëse për ndreqjen e dëmeve që i janë shkaktuar përdoruesit të vizës, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Punëve të Jashtme “Për procedurat për lëshimin e vizave”.

13. Në udhëzimin e përmendur në pikën e mësipërme miratohen procedurat e informimit e të kërkesës për anulimin, refuzimin apo bërjen të pavlefshme të vizës, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, në rastet kur shkaktohet ligjore të anulimit, refuzimit apo bërjes së pavlefshme të vizës, vërehen nga autoritete të ndryshme shtetërore përgjegjëse për kontrollin e hyrjes, të qëndrimit, tranzitimit dhe daljes së të huajve në Republikën e Shqipërisë.

III. KRITERET, PROCEDURAT DHE DOKUMENTACIONI PËR PAJISJEN ME LEJE QËNDRIMI

1. Kërkesa për lejeqëndrim ose për ripërtëritjen e saj depozitohet në sektorët ose zyrat e migracionit, pranë drejtorive rajonale për kufirin dhe migracionin, në territorin ku i huaji ka vendbanimin në çastin e aplikimit. I huaji me qëndrim të ligjshëm në Shqipëri paraqitet personalisht për aplikimin për lejeqëndrim.

Procedurat e pranimit, të miratimit apo refuzimit, si dhe të shpërndarjes së lejeve të qëndrimit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Brendshëm.

2. Për marrjen e lejeqëndrimit, në kuadër të veprimtarive ekonomike, profesionale, tregtare dhe të punësimit, i huaji duhet të depozitojë këto dokumente bazë:

a) Formularin tip nr. 8, të plotësuar.

b) Pasaportën, e cila i ka mundësuar hyrjen e ligjshme në Republikën e Shqipërisë, si dhe një fotokopje të faqeve të pasaportës, që kanë shënime zyrtare me interes.

Pasaporta duhet të skadojë të paktën 3 muaj pas mbarimit të afatit të lejes së qëndrimit të kërkuar. Pasaporta i kthehet të interesuarit në çastin e aplikimit, ndërsa fotokopja mbahet në fashikull.

c) Dëshminë e penaltetit, të marrë në vendin e origjinës dhe/ose në vendin ku i interesuari ka pasur qëndrim të ligjshëm, të përkthyer në gjuhën shqipe, lëshuar në 6-mujorin e fundit, të vërtetuar dhe të legalizuar pranë përfaqësive diplomatike apo konsullore të Republikës së Shqipërisë. Legalizimi ose jo i këtij dokumenti bazohet në detyrimet, që rrjedhin nga marrëveshjet dypalëshe.

ç) Kontratën e shitblerjes ose të marrjes me qira të banesës.

d) Certifikatat personale dhe/ose familjare, të përkthyer në gjuhën shqipe, lëshuar në 6-mujorin e fundit, të vërtetuara dhe të legalizuara pranë përfaqësive diplomatike apo konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. Legalizimi ose jo i këtyre dokumenteve bazohet në detyrimet, që rrjedhin nga marrëveshjet dypalëshe.

dh) Dy fotografi, sipas formatit të pasaportës shqiptare.

e) Deklaratën nga pritësi ose punëdhënësi për motivin e qëndrimit.

ë) Fotokopjen e lejes së punës ose fotokopjen e licencës së ushtrimit të veprimtarisë

përkatëse.

f) Certifikatën shëndetësore (për shtetas, që vijnë nga vende të prekura nga epidemi), sipas përcaktimit të Ministrisë së Shëndetësisë.

g) Mandatin e pagesës për lejeqëndrimin.

3. Për marrjen e lejeqëndrimit për qëllime studimi i huaji duhet të depozitojë këto dokumente:

a) Formularin tip nr. 8, të plotësuar.

b) Pasaportën, e cila i ka mundësuar hyrjen e ligjshme në Republikën e Shqipërisë, si dhe një fotokopje të faqeve të pasaportës që kanë shënime zyrtare me interes.

Pasaporta duhet të skadojë të paktën 3 muaj pas mbarimit të afatit të lejes së qëndrimit të kërkuar. Pasaporta i kthehet të interesuarit në çastin e aplikimit, fotokopja mbahet në fashikull.

c) Dëshminë e penalitetit të marrë në vendin e origjinës dhe/ose në vendin ku i interesuari ka pasur qëndrim të ligjshëm për gjashtëmujorin e fundit, të përkthyer në gjuhën shqipe, të vërtetuar dhe legalizuar pranë përfaqësive diplomatike apo konsullore të Republikës së Shqipërisë. Legalizimi ose jo i këtij dokumenti bazohet në detyrimet, që rrjedhin nga marrëveshjet dypalëshe.

ç) Vërtetimin nga titullari i institucionit arsimor për regjistrimin në vitin akademik.

d) Kontratën e shitblerjes ose të marrjes me qira të banesës, e cila duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe e noteruar, ose deklaratën e akomodimit nga institucioni arsimor, që e garanton atë.

dh) Dy fotografi, sipas formatit të pasaportës shqiptare.

e) Dokumentin nga një institucion bankar në Shqipëri, të depozitës bankare, për mbulimin e shpenzimeve të studimit, ose vërtetim nga institucioni arsimor përkatës, për dhënie burse studimi.

ë) Vërtetimin e mjeteve financiare për jetesë, sipas parashikimeve të nenit 10 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt".

f) Dëshminë e njohjes së gjuhës me të cilën do t'i zhvillojë studimet në Shqipëri, për shtetasit e huaj joshqipfolës.

4. Për marrjen e lejeqëndrimit për bashkim familjar të një të huaji me një të huaj tjetër me qëndrim të rregullt në Shqipëri, i pari duhet të depozitojë këto dokumente:

a) Formularin tip nr. 8, të plotësuar.

b) Pasaportën, e cila i ka mundësuar hyrjen e ligjshme në Republikën e Shqipërisë, si dhe një fotokopje të faqeve të pasaportës, që kanë shënime zyrtare me interes.

Pasaporta duhet të skadojë të paktën 3 muaj pas mbarimit të afatit të lejes së qëndrimit të kërkuar. Pasaporta i kthehet të interesuarit në çastin e aplikimit, ndërsa fotokopja mbahet në fashikull.

c) Dëshminë e penalitetit, të marrë në vendin e origjinës dhe/ose në vendin, ku i interesuari ka pasur qëndrim të ligjshëm, të përkthyer në gjuhën shqipe, të vërtetuar dhe të legalizuar pranë përfaqësive diplomatike apo konsullore të Republikës së Shqipërisë. Legalizimi ose jo i këtij dokumenti bazohet në detyrimet, që rrjedhin nga marrëveshjet dypalëshe.

ç) Fotokopjen e lejes së qëndrimit të bashkëshortit/es, ose partnerit/es civile.

d) Certifikatat personale dhe familjare, të përkthyer në gjuhën shqipe, lëshuar në 6-mujorin e fundit, të vërtetuara dhe të legalizuara pranë përfaqësive diplomatike apo konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. Legalizimi ose jo i këtyre dokumenteve bazohet në detyrimet, që rrjedhin nga marrëveshjet dypalëshe.

dh) Dy fotografi sipas formatit të pasaportës shqiptare.

e) Kontratën e shitblerjes ose të marrjes me qira të banesës. Banesa duhet të jetë në

sipërfaqe të mjaftueshme, për të siguruar një jetesë normale për numrin e personave pas bashkimit.

ë) Fotokopjen e dokumentit të kontributeve të sigurimeve shëndetësore (për shtetasin e huaj me qëndrim në Shqipëri).

f) Kërkesën e bashkëshortit/es ose partnerit/es civil pritës.

g) Deklaratën noteriale të partnerëve civilë.

Dokumentacioni i partnerit/es civil shërben vetëm për rastet e parashikuara në nenin 21 të ligjit nr. 9959, datë 17.07.2008 “Për të huajt”.

5. Për marrjen e lejeqëndrimit për bashkim familjar të një të huaji, që hyn me vizë, dhe një shtetasi shqiptar, i huaji duhet të depozitojë këto dokumente:

a) Formularin tip nr.8, të plotësuar.

b) Pasaportën, e cila i ka mundësuar hyrjen e ligjshme në Republikën e Shqipërisë, si dhe një fotokopje të faqeve të pasaportës që kanë shënime zyrtare me interes.

Pasaporta duhet të skadojë të paktën 3 muaj pas mbarimit të afatit të lejes së qëndrimit të kërkuar. Pasaporta i kthehet të interesuarit në momentin e aplikimit, ndërsa fotokopja mbahet në fashikull.

c) Fotokopjen e dokumentit të identifikimit ose të pasaportës së bashkëshortit/es shqiptar/e.

ç) Certifikatën familjare dhe të martesës në vendin e tij të origjinës, të përkthyer në gjuhën shqipe, lëshuar brenda 6-mujorit të fundit, të noterizuar dhe të legalizuar pranë përfaqësive diplomatike apo konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. Legalizimi ose jo i këtyre dokumenteve bazohet në detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet dypalëshe.

d) Dy fotografi sipas formatit të pasaportës shqiptare.

dh) Dokumentet të cilat vërtetojnë bashkëjetesën e tyre për një periudhë kohore jo më pak se një vit (kontratë qiraje të përbashkët, fotografi të ndryshme etj.).

6. Për marrjen e lejeqëndrimit për bashkim familjar me një shtetas shqiptar, i huaji, që hyn pa vizë duhet të depozitojë këto dokumente:

a) Formularin tip nr. 8, të plotësuar.

b) Pasaportën, e cila i ka mundësuar hyrjen e ligjshme në Republikën e Shqipërisë, si dhe një fotokopje të faqeve të pasaportës, që kanë shënime zyrtare me interes.

Pasaporta duhet të skadojë të paktën 3 muaj pas mbarimit të afatit të lejes së qëndrimit të kërkuar. Pasaporta i kthehet të interesuarit në çastin e aplikimit, ndërsa fotokopja mbahet në fashikull.

c) Fotokopjen e dokumentit të identifikimit ose të pasaportës së bashkëshortit/es shqiptar/e.

ç) Certifikatën familjare nga vendi i origjinës dhe certifikatën e martesës, të lëshuar në Shqipëri ose në vendin e origjinës, brenda 6-mujorit të fundit, të përkthyer në gjuhën shqipe, të vërtetuara dhe të legalizuar pranë përfaqësive diplomatike apo konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. Legalizimi ose jo i këtyre dokumenteve bazohet në detyrimet, që rrjedhin nga marrëveshjet dypalëshe.

d) Dy fotografi, sipas formatit të pasaportës shqiptare.

7. Për marrjen e lejeqëndrimit, në kuadër të veprimtarive humanitare ose fetare, i huaji duhet të depozitojë këto dokumente:

a) Formularin tip nr. 8, të plotësuar.

b) Pasaportën, e cila i ka mundësuar hyrjen e ligjshme në Republikën e Shqipërisë, si dhe një fotokopje të faqeve të pasaportës, që kanë shënime zyrtare me interes.

Pasaporta duhet të skadojë të paktën 3 muaj pas mbarimit të afatit të lejes së qëndrimit

të kërkuar. Pasaporta i kthehet të interesuarit në çastin e aplikimit, ndërsa fotokopja mbahet në fashikull.

c) Dëshminë e penalitetit të marrë në vendin e origjinës, dhe/ose në vendin ku i interesuari ka pasur qëndrim të ligjshëm, të përkthyer në gjuhën shqipe, të vërtetuar dhe të legalizuar pranë përfaqësive diplomatike apo konsullore të Republikës së Shqipërisë. Legalizimi ose jo i këtij dokumenti bazohet në detyrimet, që rrjedhin nga marrëveshjet dypalëshe.

ç) Certifikatat personale e familjare (sipas rasteve specifike), të përkthyer në gjuhën shqipe, të lëshuara në 6-mujorin e fundit, të vërtetuara dhe të legalizuara pranë përfaqësive diplomatike apo konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. Legalizimi ose jo i këtyre dokumenteve bazohet në detyrimet, që rrjedhin nga marrëveshjet dypalëshe.

d) Dy fotografi, sipas formatit të pasaportës shqiptare.

dh) Fotokopje e lejes së ushtrimit të veprimtarive humanitare ose deklaratë nga institucioni fetar pritës.

8. Për pajisjen me lejeqëndrimi për rastet përjashtimore, të përcaktuara në nenin 31 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt", i huaji duhet të depozitojë dokumentet e mëposhtme:

a) Formularin tip nr. 8, të plotësuar.

b) Dokumentin e udhëtimit ose të identifikimit, nëse ka.

c) Kërkesë nga institucioni shtetëror për pajisje me lejeqëndrimi jo më të gjatë se një vit, ku duhet të parashtrohet arsyeja si rast përjashtimor.

ç) Dy fotografi, sipas formatit të pasaportës shqiptare.

Procedurat e aplikimit dhe të pajisjes me lejeqëndrimi për rastet përjashtimore miratohen me udhëzim të Ministrit të Brendshëm.

9. Për marrjen e lejeqëndrimit, për motive të tjera, i huaji duhet të depozitojë këto dokumente:

a) Formularin tip nr. 8, të plotësuar.

b) Pasaportën, e cila i ka mundësuar hyrjen e ligjshme në Republikën e Shqipërisë, si dhe një fotokopje të faqeve të pasaportës, që kanë shënime zyrtare me interes.

Pasaporta duhet të skadojë të paktën 3 muaj pas mbarimit të afatit të lejes së qëndrimit të kërkuar. Pasaporta i kthehet të interesuarit në çastin e aplikimit, ndërsa fotokopja mbahet në fashikull.

c) Dëshminë e penalitetit, të marrë në vendin e origjinës dhe/ose në vendin, ku i interesuari ka pasur qëndrim të ligjshëm, të përkthyer në gjuhën shqipe, lëshuar në 6-mujorin e fundit, të vërtetuar dhe të legalizuar pranë përfaqësive diplomatike apo konsullore të Republikës së Shqipërisë. Legalizimi ose jo i këtij dokumenti bazohet në detyrimet, që rrjedhin nga marrëveshjet dypalëshe.

ç) Certifikatën e pronësisë së banesës.

d) Dëshminë bankare, për mundësitë financiare, për të mbuluar shpenzimet, sipas motivit të qëndrimit, për kohën e kërkuar të qëndrimit.

dh) Certifikatat personale dhe familjare, të përkthyer në gjuhën shqipe, lëshuar në 6-mujorin e fundit, të vërtetuara dhe të legalizuara pranë përfaqësive diplomatike apo konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. Legalizimi ose jo i këtyre dokumenteve bazohet në detyrimet, që rrjedhin nga marrëveshjet dypalëshe.

e) Dy fotografi, sipas formatit të pasaportës shqiptare.

ë) Deklaratën për motivet e qëndrimit.

f) Mandatpagesën për lejen e qëndrimit.

10. Për ripërtëritjen e lejes së qëndrimit, i huaji duhet të depozitojë këto dokumente:

a) Formularin tip nr. 8, të plotësuar.

b) Pasaportën, e cila i ka mundësuar hyrjen e ligjshme në Republikën e Shqipërisë, si dhe një fotokopje të faqeve të pasaportës, që kanë shënime zyrtare me interes.

Pasaporta duhet të skadojë të paktën 3 muaj pas mbarimit të afatit të lejes së qëndrimit të kërkuar. Pasaporta i kthehet të interesuarit në çastin e aplikimit, ndërsa fotokopja mbahet në fashikull.

c) Fotokopjen e lejes së përkohshme të qëndrimit, të mëparshme.

ç) Dokumentin/et, që vërteton/jnë arsyen/nevojën për ripërtëritjen e lejes së qëndrimit, të njëjtë/a me atë/o të përcaktuar/a në këtë vendim, për marrjen e lejes së përkohshme të qëndrimit, përjashtuar dëshminë e penalitetit nga vendi i origjinës.

11. Për pajisjen me lejeqëndrimi dyvjeçare, i huaji duhet të ketë qëndrim të ligjshëm për një periudhë njëvjeçare (me lejeqëndrimi të përkohshme) në Republikën e Shqipërisë dhe duhet të depozitojë këto dokumente:

a) Formularin tip nr. 8, të plotësuar.

b) Pasaportën, e cila i ka mundësuar hyrjen e ligjshme në Republikën e Shqipërisë, si dhe një fotokopje të faqeve të pasaportës, që kanë shënime zyrtare me interes.

Pasaporta duhet të skadojë të paktën 3 muaj pas mbarimit të afatit të lejes së qëndrimit të kërkuar. Pasaporta i kthehet të interesuarit në çastin e aplikimit, ndërsa fotokopja mbahet në fashikull.

c) Fotokopjen e lejes së përkohshme të qëndrimit, të mëparshme.

d) Dokumentin/et, që vërteton/jnë arsyen/nevojën e dhënies së lejes së qëndrimit 2-vjeçare, të njëjtë/a me atë/o të përcaktuar/a në këtë vendim, për marrjen e lejes së përkohshme të qëndrimit, përjashtuar dëshminë e penalitetit nga vendi i origjinës.

